



UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA"
FAKULTETI AGROBIZNESIT

Programi: Ekologji e Aplikuar në Agrobiznes (BSc)

Emërtimi i programit të studimit:	Ekologji e Aplikuar në Agrobiznes
Niveli i kualifikimit sipas KKK:	Arsimi i lartë – Cikli i parë i Bolonjës (Bachelor) BSc. Niveli 6 sipas KKK
Numri ECTS kredive:	180
Grada akademike (kualifikimi i fituar):	Bachelor i Shkencës Ekologji e Aplikuar në Agrobiznes (BSc)
Kohëzgjatja e programit të studimit:	Tre vite / 6 semestra
Qëllimi dhe objektivat e programit të studimit:	<p>Qëllimi i programit "Ekologji e aplikuar në Agrobiznes (BSc)" është të përgatisë profesionistë të aftë që të integrojnë njohuritë ekologjike dhe ekonomike në fushën e agrobiznesit, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor dhe mbrojtjen e mjedisit. Programi synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të rajonit të Pejës dhe të Kosovës përmes formimit të specialistëve që kuptojnë ndërveprimin midis bujqësisë dhe mjedisit; • Të sigurojë arsim cilësor që u mundëson studentëve punësim të suksesshëm në sektorin publik dhe privat të agrobiznesit dhe ekologjisë; • Të nxisë inovacionin, kërkimin shkencor dhe aplikimin e teknologjive të reja për qëndrueshmëri mjedisore dhe ekonomike. <p>Objektivat e programit të studimit:</p> <p>Objektivat e programit janë të strukturuar për të mbështetur qëllimin kryesor dhe përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Formimin profesional të studentëve me njohuri të avancuara teorike dhe praktike në fushat e ekologjisë së aplikuar dhe agrobiznesit. • Zhvillimin e aftësive analitike për të vlerësuar ndikimet ekologjike të praktikave bujqësore dhe për të hartuar strategji për reduktimin e efekteve negative në mjedis. • Ndërtimin e kompetencave kërkimore dhe laboratorike për analizimin e parametrave mjedisorë dhe të produkteve bujqësore.

	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimin e teknologjive inovative dhe praktikave të qëndrueshme në prodhim, përpunim dhe menaxhim të burimeve natyrore. • Përgatitjen për tregun e punës në sektorin e agrobiznesit, mjedisit, organizatave qeveritare dhe OJQ-ve mjedisore. • Nxitjen e përgjegjësisë ekologjike dhe sociale, duke zhvilluar aftësinë për komunikim profesional dhe menaxhim të qëndrueshëm të resurseve natyrore. • Integrimin e kërkimeve shkencore në zhvillimin e politikave dhe praktikave të qëndrueshme bujqësore në nivel lokal dhe kombëtar.
<p>Rezultatet e pritshme të nxënësit:</p>	<p>Pas përfundimit të programit të studimit, studenti do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kupton dhe shpjegon konceptet themelore ekologjike dhe lidhjen e tyre me agrobiznesin, duke përvetësuar njohuri mbi parimet bazë nga shkencat bujqësore dhe ekologjike. • Posedon shkathtësi në përdorimin e pajisjeve dhe aparaturave laboratorike për kryerjen e analizave të ndryshme nga fusha e ekologjisë dhe bujqësisë. • Identifikon, vlerëson dhe zbaton praktika të qëndrueshme bujqësore dhe strategji për të reduktuar gjurmën mjedisore të aktiviteteve të agrobiznesit. • Kryen analiza të kosto-benefiteve dhe të vlerësojnë ndikimet ekologjike dhe përfitueshmërinë e praktikave të ndryshme bujqësore. • Posedon aftësi për të kryer hulumtime shkencore, duke përfshirë mbledhjen, analizimin dhe interpretimin e të dhënave në kontekstin e agrobiznesit dhe ekologjisë. • Vlerëson dhe aplikon teknologji dhe praktika inovative që rrisin qëndrueshmërinë në agrobiznes. • Posedon aftësi për planifikim të projekteve në agrobiznes duke përfshirë Monitorimi dhe vlerësimi i performancës së projekteve. • Integron parimet ekologjike në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit dhe të vlerësojnë ndikimet mjedisore të praktikave të burimit, prodhimit dhe shpërndarjes. • Komunikon rëndësinë e përgjegjësisë ekologjike tek palët e interesuara, duke përfshirë klientët, investitorët dhe komunitetin, dhe të zhvillojnë strategji marketingu për produkte të qëndrueshme. • Analizon tendencat e tregut dhe preferencat e konsumatorëve për produkte të qëndrueshme, dhe të zbaton parimet ekologjike në skenarët e agrobiznesit të botës reale përmes studimeve të rasteve, projekteve dhe praktikave.
<p>Procedurat e mësimdhënies:</p>	<p>Procesi i mësimdhënies në programin “Ekologji e Aplikuar në Agrobiznes” zhvillohet në përputhje me standardet</p>

bashkëkohore të arsimit të lartë dhe me parimet e sistemit të Bolonjës, duke vendosur **studentin në qendër të procesit të të nxënit**. Qëllimi kryesor është të sigurohet që çdo student të zhvillojë kompetenca profesionale, shkencore dhe praktike të nevojshme për tregun modern të punës.

1. Parimet bazë të mësimdhënies

Mësimdhënia bazohet në këto parime kryesore:

- Përdorimi i metodave interaktive dhe gjithëpërfshirëse;
- Integrimi i pjesës teorike me atë praktike (raporti 60% teori / 40% praktikë);
- Nxitja e mendimit kritik dhe kreativ;
- Zhvillimi i kompetencave kërkimore dhe të zgjidhjes së problemeve;
- Bashkëpunimi aktiv midis stafit akademik dhe studentëve.

2. Format dhe metodat e mësimdhënies

Procesi mësimor realizohet përmes një kombinimi të **formave tradicionale dhe moderne** të mësimdhënies:

- **Ligjërata teorike**, ku prezantohen konceptet bazë dhe kornizat shkencore;
- **Ushtrime praktike** në laboratorë, ferma eksperimentale dhe biznese partnere të agrobiznesit;
- **Seminare dhe prezantime** ku studentët zhvillojnë aftësi komunikimi dhe analize;
- **Punë në terren**, për studime mjedisore dhe monitorim ekologjik;
- **Projektet kërkimore** individuale apo në grup, të orientuara drejt problemeve reale;
- **Studime rasti dhe simulime**, për të zhvilluar vendimmarrjen dhe zbatimin praktik të teorisë;
- **Mentorim dhe konsultime individuale** për mbështetje akademike dhe profesionale.

3. Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Në përputhje me zhvillimet bashkëkohore, përdoren **platformat digjitale** dhe **sistemet elektronike të menaxhimit të mësimi (SMU / SEMS)** për:

- publikimin e materialeve mësimore, syllabus-it dhe orareve;
- komunikimin ndërmjet studentëve dhe profesorëve;
- dorëzimin dhe vlerësimin e punimeve;
- ndjekjen e pjesëmarrjes dhe rezultateve të studentëve.

Gjithashtu, përfshihen **simulime mjedisore digjitale, softuerë analitikë** dhe **platforma kërkimore** që ndihmojnë studentët në hulumtime shkencore dhe analiza laboratorike.

4. Vlerësimi dhe përmirësimi i procesit të mësimdhënies

Cilësia e mësimdhënies vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme përmes:

- pyetësorëve të studentëve në fund të çdo semestri;
- vlerësimeve nga koordinatori i cilësisë dhe dekanati;

	<ul style="list-style-type: none"> • raportimeve periodike të profesorëve mbi ecurinë e mësimit; • analizës së performancës së studentëve në provime dhe projekte; • takimeve të rregullta ndërmjet stafit akademik dhe administratës për përmirësim të metodave didaktike.
<p>Procedurat dhe llojet e vlerësimit të përdorura (notimi i studentëve):</p>	<p>Sipas nenit 104, 105, 106 të Statutit të UHZ, vlerësimi përfundimtar i studentëve bëhet me anë të testimit me shkrim dhe me gojë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesa e vlerësimit dhe notimit të studentëve varet nga lënda dhe kriteret e përdorura në mënyrë individuale nga mësimmshënësi i lëndës. • Studenti vlerësohet gjatë gjithë semestrit përmes testeve, punimeve seminareve, pjesëmarrjeve në projekte, konferenca shkencore, etj. • Metodatat e vlerësimit përcaktohen në syllabuse të secilës lëndë mësimore veç e veç në kuadër të programit, <p>Një shembull vlerësimi është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrja aktive në mësim.....10 për qind • Detyrat, ushtrimet.....10 për qind • Testi i parë..... .20 për qind • Testi i dytë.....20 për qind • Provimi përfundimtar..... 40 për qind • Total 100% <p>Një shembull i kriterit të notimit është si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 0-50.99%(5) • 51-60.99%(6) • 61-70.99%(7) • 71-80.99%(8) • 81-90.99%(9) • 91-100%(10)
<p>Ndarja e lëndëve të programit sipas rëndësisë:</p>	
<p>a). Lëndë të përgjithshme:</p>	<p>Viti I – semestri i parë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Agroklimatologji 2. Biologji 3. Kimi e përgjithshme 4. Bazat e ekologjisë <p>Viti I – semestri i dytë</p> <ol style="list-style-type: none"> 5. Bazat e botanikës 6. Pedologjia e përgjithshme 7. Zoologjia agrare 8. Parimet e agroekonomisë 9. Agroekologjia <p>Viti II – semestri i tretë</p> <ol style="list-style-type: none"> 10. Bazat e gjentikes 11. Bazat e fiziologjisë së bimëve 12. Hulumtimet në teren dhe metodat laboratorike në agroekologji 13. Biokimi 14. Të ushqyerit e bimëve

	<p>Viti II – semestri katër 15. Mikrobiologji dhe Mykologji 16. Blegtori 17. Sistemet e menaxhimit te ujerave 18. Agroteknika e aplikuar 19. Ekonomia e ndermmarrjeve bujqesore dhe analiza e tregut</p> <p>Viti III – semestri pestë 20. Mbrojtja e bimëve 21. Zonat e mbrojtura dhe menaxhimi i tyre 22. Analizimi i të dhënave në agrekologji dhe agrobiznes 23. Marketingu i produkteve agroekologjike</p> <p>Viti III – semestri gjashtë 24. Trajtimi dhe menaxhim i mbeturinave 25. Metodologji e hulumtimit shkencor 26. Resurseve natyrore dhe menaxhimi i tyre 27. Ndryshimet Klimatike</p>
<p>b) Lëndë zgjedhore:</p>	<p>Viti I – semestri i parë 28. Anglisht 29. Informatike e aplikuar</p> <p>Viti I – semestri i dytë 30. Ndërmarrësia 31. Bioprodhimet</p> <p>Viti II – semestri i tretë 32. Organizimi i ndermarrjeve në agrobiznes 33. Menaxhimi i fermave në bujqesi 34. Akuakulture</p> <p>Viti II – semestri katër 35. Hortikultur dhe kultivim i perimeve 36. Zhvillim i qendrushem në agrobiznes 37. Apikultur</p> <p>Viti III – semestri pestë 38. Inovacion në agroindustri 39. Biomonitroimi 40. Bimet mjeksore dhe aromatike 41. E drejta mjedisore</p> <p>Viti III – semestri gjashtë 42. Ekologji e mjedisve të ndotura 43. Menaxhim i projekteve dhe projektet në agrobiznes 44. Teknologjia e pasvjeljës 45. Punim diplome (BSc)</p>
<p>Perspektiva e studentit – Mundësitë e punësimit pas diplomimit në Ekologjia e aplikuar ne Agrobiznes (BSc)</p>	<p>Programi Ekologjia e Aplikuar në Agrobiznes ofron një qasje ndërdisiplinore që kombinon njohuritë në ekologji, bujqësi dhe menaxhim biznesi, duke përgatitur studentët për të ndërtuar ura të forta ndërmjet zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit. Ky program synon zhvillimin e aftësive praktike për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, planifikimin ekologjik të</p>

	<p>aktiviteteve bujqësore dhe aplikimin e parimeve të ekonomisë së gjelbër në sektorin agro-industrial.</p> <p>Pas diplomimit, studentët e këtij programi mund të punësohen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërmarrje agroindustriale dhe kompani agrobiznesi, në rolet e menaxherit të qëndrueshmërisë, specialistit për ndikimin mjedisor ose këshilltarit për standardet ekologjike të prodhimit; • Institucione publike dhe agjenci shtetërore, në sektorët që merren me menaxhimin e mjedisit, kontrollin ekologjik dhe zhvillimin rural të qëndrueshëm; • Organizata ndërkombëtare dhe OJQ, që fokusohen në ekologjinë e aplikueshme, bujqësinë organike dhe politikatat e gjelbra; • Sektorin e certifikimit dhe standardizimit, si auditorë të sistemeve të menaxhimit mjedisor (ISO 14001), standardeve organike dhe praktikave të qëndrueshme të prodhimit; • Institucione kërkimore dhe universitare, si bashkëpunëtorë në projektet e ekologjisë bujqësore, menaxhimit të biodiversitetit dhe analizave të ndikimit mjedisor; • Sipërmarrjen individuale, përmes themelimit të fermave organike, bizneseve të gjelbra apo iniciativave për riciklim dhe menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve bujqësore. <p>Në përputhje me perceptimet pozitive të studentëve, programi Ekologjia e Aplikuar në Agrobiznes e pozicionon të diplomuarin si profesionist me vlerë në tregun modern të punës, ku kërkohet balancë ndërmjet produktivitetit ekonomik dhe ruajtjes së ekuilibrit ekologjik. Ky program forcon aftësitë për analiza sistemike, menaxhim të qëndrueshëm dhe inovacion ekologjik — elemente thelbësore për ndërtimin e një agrobiznesi të qëndrueshëm dhe konkurrues.</p>
--	--

Kostoja e shpenzimeve

Lloji i shpenzimit	Përshkrimi	Vlerë e përafërt (€/vit)
Librat dhe materialet mësimore	Librat, artikujt shkencorë, softuerë mësimor	100 – 300
Pajisjet laboratorike/fushore	Instrumente për matje mjedisore, material laboratorik	250 – 500
Transporti dhe udhëtimet	Udhëtime për vizita studimore, ekskursionet, praktika	100 – 300
Akomodimi dhe ushqimi	Shpenzime për qëndrim dhe ushqim gjatë praktikave apo projekteve në terren	500 – 750
Shpenzime të tjera personale	Shëndet, komunikim, internet, material shtesë	100 – 200